



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**04.05.2022**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik **JUBICA. SHPK**  
Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108, Shkoder,

Procedura e prokurimit/lotit: **“E Hapur - prokurim me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-23684-03-31-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, Loti 1 (2022)”**

**Fondi limit: 191.663.216 (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) Lek pa TVSH.**

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 26 javë**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini Nr. 43, datë 4 Prill 2022**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto  X

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim  □

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

## 1. JUBICA. SHPK

K26529001I

Vlera: **181.000.000** (njëqind e tetëdhjetë e një milion) lek pa TVSH

## 2. RSM COMPANY SHPK

L04803001U

Vlera: **170.044.163** (njëqind e shtatëdhjetë milion e dyzet e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre) lek pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

### 1. RSM COMPANY SHPK

L04803001U

1. Operatori ekonomik “**RSM COMPANY**” nuk kualifikohet, pasi nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat standarde të tenderit.

#### **Arsyet e skualifikimit si më poshtë:**

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.2.1

*“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit)”. (Xhiroja e paraqitur nga operatori nuk përmbush kriterin).*

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.1

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme”. (Puna e ngjashme e paraqitur nga operatori nuk e përmbush kriterin).*

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2 Operatori ekonomik nuk disponon pikat e licencës si më poshtë:

NP-11/B (Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

NS-6/D (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

- Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.6, pasi në kriter drejtuesi i projektit duhet të jetë ing. ndërtimi me eksperiencë pune. Operatori ekonomik ka paraqitur drejtuesin

teknik të punimeve me profesion Topograf, kjo në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në DST.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **JUBICA. SHPK** me adresë: Rruga Luigj Gurakuqi, Kuklejt, nr 108, Shkoder, me NUIS: **K26529001I**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **181.000.000 (njëqind e tetëdhjetë e një milion) lek pa TVSH** / totali i pikëve të marra sipas sistemit **[263.85]**, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në *nenin 109 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik"*.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Evis Berberi**